



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2023:131075

Datë: 25.03.2025

Numri i dokumentit: 07038620

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.246/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekaliu, me zyrtaren ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit A.D nga Vushtrria, të cilin e përfaqëson sipas detyrës zyrtare av. Ruzhdi Maloku me seli të zyrës në Vushtrri, për shkak të veprës penale *Lëndimi i rëndë trupor* nga neni 186 par. 3, në par.3.2 lidhur me par. 2 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.830/2023 të datës 28.08.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 21.03.2025, në praninë e Prokurorit të Shtetit Valon Cervadiku, të pandehurit A.D dhe mbrojtësit av. Ruzhdi Maloku, më datë 21.03.2025 shpalli publikisht, ndërsa me datë 25.03.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. I pandehuri: A.D, nga i ati A..., e ëma R..., e vajzërisë H..., i lindur më ..., me vendbanim në Vushtrri, me numër personal ..., të kryer shkollën fillore, pensionist- veteran i luftës, i martuar, prind i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa gjykuar.

SHPALLET FAJTOR

I. SEPSE: Me datë 10.06.2023 rreth orës 18:10 në Vushtrri, në rrugën "...", me dashje dhe qëllim që ti shkaktojë lëndime trupore të dëmtuarit F.M, si pasojë e mosmarrëveshjeve paraprake të cilin e kishin pasur javë më parë dhe në shenjë hakmarrje me një mjet të rrezikshëm me të cilin

mund të shkaktohet lëndimi i rëndë trupor dhe atë stupc të drurit të gjatë rreth një metër, deri sa i dëmtuari kishte qenë duke kaluar tek tregu i druve, i shkon fshehurazi pas dhe posa e takon, prapa shpinës dhe në mënyrë tinzare e godet në kokë, e që për pasojë i dëmtuari pëson lëndime trupore dhe atë thyerje e bazës së kafkës në pjesën zverkore majtas, për pasojë me hematomë cerebrale dhe subdurale në pjesën zverkore majtas dhe me aerocefali, si dhe plagë mbretëse në pjesën zverkore me kontuzione të kokës të shkaktuara nga mjeti i fortë dhe i rëndë mbretës, lëndime këto të natyrës së rëndë trupore,

Me këtë ka kryer veprën penale ‘Lëndimi i rëndë trupor’ nga neni 186 par. 3, në par.3.2 lidhur me par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 42, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364, 449 dhe 450 të KPPK-së,

## E G J Y K O N

I. ME DËNIM ME BURGIM EFEKTIV në kohëzgjatje prej një viti, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Koha e kaluar në paraburgim nga data 10.06.2023 e deri me datën 11.07.2023, do të llogaritet në dënimin e shqiptuar.

III. DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

IV. Pala e dëmtuar F.M, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

## A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.830/2023 të datës 28.08.2023 kundër të pandehurit A.D nga Vushtrria, për shkak të

veprës penale *Lëndimi i rëndë trupor* nga neni 186 par. 3, në par.3.2 lidhur me par. 2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 21.03.2025, në të cilën seancë ka prezantuar Prokurori i Shtetit Valon Cervadiku, i pandehuri A.D së bashku me mbrojtësin e tij av. Ruzhdi Maloku.

Pas leximit të aktakuzës, nga ana e Prokurorit të Shtetit, dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, si dhe sqarimit të benefiteve dhe pasojave të pranimit të fajësisë, të njëjtit i është ofruar mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë. I pandehuri A.D ka deklaruar se ndjehet fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, ka shtuar se nuk është dashur të ndodhë kjo dhe se i vjen keq që ka ndodhur, palës së dëmtuar i ka kërkuar falje dhe janë pajtuar, janë marrë vesh, po ashtu ka shtuar se i vjen keq prej palës tjetër si dhe prej familjes së tij për atë që ka ndodhur, si dhe e ndjen veten plotësisht fajtor.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë, pasi që pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, pa presion, i bazuar në provat materiale si në aktakuzë dhe është bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij dhe është në përputhje me nenin 242 të KPPK-së, andaj gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtorë, ta dënojë sipas ligjit si dhe me rastin e shqiptimit të dënimit, pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, ndërsa si rrethanë rënduese dashjen e lartë në kryerjen e veprës dhe dëmin që është shkaktuar nga kjo vepër.

Avokati mbrojtës lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pas konsultimit me të mbrojturin e tij, para fillimit të seancës i njëjti në mënyrë vullnetare dhe pa imponime, në tërësi e pranon veprën penale me të cilën ngarkohet në aktakuzë, dhe i vie keq që ka ardhur deri te ky rast, dhe premtion se në të ardhmen asnjëherë nuk do të bie në kundërshtim me ligjin. Ka shtuar se me palën e dëmtuar janë pajtuar, ashtu që raportet mes tyre janë të mira, dhe se i mbrojturi i tij gjerë më tani asnjëherë nuk ka qenë i gjykuar për ndonjë vepër penale me vendim të formës së prere. Gjithashtu me rastin e shqiptimit të dënimit gjykatës i ka propozuar që rrethana lehtësuese të merr gjendjen e të mbrojturit të tij dhe të shqipton një dënim sa më të ultë, me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që i mbrojturi i tij në të ardhmen mos të kryejë vepra penale. Gjykatës i ka dorëzuar procesverbalin mbi pajtim me palën e dëmtuar.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 242 par. 2 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Faktet e çështjes në raport me provat që përmban aktakuza.

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: raporti fillestar i datës 10.06.2023, raporti i policit i datës 10.06.2023, procesverbali i marrjes në pyetje i të dëmtuarit F.M i datës 26.06.2023, procesverbali i marrjes në pyetje i të pandehurit A.D i datës 10.06.2023, procesverbali i marrjes në pyetje i të pandehurit A.D i datës 07.07.2023 të dhënë në prokurori, raportet mjekësore në emër të dëmtuarit me numër të protokollit 5894, të datës 10.06.2023, raport shtesë lidhur me lëndimet e të dëmtuarit të datës 11.06.2023, fotodokumentacioni i të pandehurit, fletëlëshimi i QKUK-së, Prishtinë, me numër të amzës 3989 të datës 11.06.2023, procesverbali mbi pajtimin, i datës 03.07.2023, CD-ja, ekspertiza mjeko ligjore e datës 28.07.2023, e Dr. Naim Haliti, raporti specialistik i datës 10.08.2023, informacionet mbi të kaluarën kriminale në emër të të pandehurit, si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Për veprën penale Lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par. 3, në par.3.2 lidhur me par. 2 të KPRK-së, ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të akuzuarit për veprën penale Lëndimi i rëndë trupor, vendosi që të shqiptoj dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e konform nenit 79 par. 1 të KPRK-së, dhe nenit 364 par. 2 nën par 2.2 të KPPK-së, në dënimin e shqiptuar, është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 10.06.2023 e deri me datën 11.07.2023

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si

rrethana rënduese për të pandehurin ka gjetur, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore, ndërsa në kuadër të rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pendimin e tij për kryerjen e kësaj vepra penale, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do të përsërisë vepra penale, më parë i pa gjykuar.

Ashtu që gjykata, pasi i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 71 par. 1 nën par. 1.3, të KPRK-së, për të zbutur dënimin me burgim, dhe me këtë rast gjykata duke zbatuar nenin 72 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK-së, ku përcaktohet se *“nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej tre (3) viteve, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vit burgim”*, andaj gjykata pasi që gjeti rrethanat lehtësuese të përshkuara si më lartë, zbuti dënimin e të pandehurit për veprën penale Lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par. 3, në par.3.2 lidhur me par. 2 të KPRK-së, në të cilin është paraparë shqiptimi i dënimit me burgim prej 3 deri në 10 vite, e që dënimin me burgim e zbuti nën dënimin minimal prej tre (3) viteve, duke i shqiptuar të pandehurit dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se në rastin konkret, edhe me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bien në kundërshtim me ligjin, t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 dhe nenit 450 par. 1 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin që palën e dëmtuar ta udhëzoj në kontest juridiko civil, gjykata e ka bazuar në nenin 462 par. 2 të KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.246/2023, datë 25.03.2025

Zyrtarja Ligjore

Arta Jusufi

Gj y q t a r i

Naim Rekalio

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.

Numri i lëndës: 2023:131075  
Datë: 25.03.2025  
Numri i dokumentit: 07038620